



Die Gewerkschaft.

Vapa në ndërtimtari: Kujdes!

Ditët me vapë e bëjnë punën të mundimshme dhe të rrezikshme. Punëdhënësi është përgjegjës për shëndetin e të punësuarve të tij. Kjo domethënë që, ai duhet:

- t'i informojë punëtorët për rreziqet nga dielli, vapa dhe Ozoni;
- Të vë në dispozicion mjaft mjete mbrojtëse si ujë, krem mbrojtës nga dielli etj.;
- Të organizojë vende të freskëta për pauzë dhe me hije nën strehë;
- Ta përshtatë organizimin e punës dhe temperaturat (më shumë pauza, ritmin e punës së rëndë, orarin e punës,...)
- të garantojë ndihmën e parë dhe vëzhgimin e punëtorëve dhe t'i sigurojë ata në rast të dëmtimeve shëndetësore.

Në anën tjetër, për të mbrojtur shëndetin e vet, secili punëtor do të bënte mirë që:

- të mbrojë lëkurën me **rroba** dhe **krem dielli**;
- të mbajë **syza dielli**, për të mbrojtur sytë;
- medoemos të pijë **mjaftueshëm ujë**, në ditë të nxehta së paku 3 deri 6 litra.

Tabela në vijim ofron disa këshilla, se si duhet të silleni në kantierin e ndërtimtarisë kur bën vapë:

Nëse nuk janë përmbushur një ose më shumë nga këto parakushte, interveno direkt tek kryepunëtori apo telefoni sekretarin tënd të Unia.

Temperatura	Orari i punës	Pauzat	Ngarkesa fizike
prej 25°C	Përshtatja, puna të fillojë herët në mëngjes	Pauzat gjithnjë në hije	Të reduktohen peshat dhe ngarkesat fizike
prej 30°C	Të evitohen punët e rënda në diell të drejtpërdrejtë	Pauza shtesë nga 5 minuta për çdo orë	Përgjysmim i peshave dhe ngarkesave trupore
prej 35°C	Reduktim i punëve vetëm në orët e hershme të mëngjesit, përndryshe ndërprerja e plotë e punës	Pauza shtesë nga 15 minuta për çdo orë	Ndalim i peshave të rënda apo ngarkesave të tjera trupore